



# **Analiza e Planifikimit të Prokurimit: Ndryshimet e Nevojshme dhe Sfidat për Autoritetet Kontraktuese**

**Raport i monitorimit të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive**

*Analiza e planifikimit të prokurimit: Ndryshimet e nevojshme  
dhe sfidat për autoritetet kontraktuese*

Prishtinë, korrik 2024

Autor: Leorentë Alija

Redaktore: Albulena Nrecaj - Musliu

Ekipi hulumtues: Leorentë Alija, Valmir Ilazi, Arbër Kabashi

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë organizatës Iniciativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyrë, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres – INPO dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

*Përkrahur nga:*



## Përmbajtja

|                                                                                                      |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Lista e shkurtesave.....                                                                          | 5  |
| 2. Përmbledhje ekzekutive.....                                                                       | 6  |
| 3. Metodologjia.....                                                                                 | 8  |
| 4. Ndërthurja e problemeve të përhershme në planifikimin e prokurimit: Analizë dhe Alternativa.....  | 10 |
| 5. Pasqyrë e përgjithshme e buxhetit të planifikuar në nivel qendror.....                            | 12 |
| 6. Planifikimi i prokurimit në nivel qendror.....                                                    | 14 |
| 6.1. Respektimi i Formularit B01 - Planifikimi i prokurimit.....                                     | 14 |
| 6.2. Respektimi i planit të prokurimit në kontratat për furnizim .....                               | 17 |
| 6.3. Respektimi i planit të prokurimit në kontratat për shërbime .....                               | 19 |
| 6.4. Respektimi i planit të prokurimit në kontratat për punë .....                                   | 20 |
| 7. Planifikimi buxhetor vs Planifikimi i prokurimit.....                                             | 23 |
| 7.1. Krahësimi i buxhetit dhe planit të prokurimit për investime kapitale .....                      | 23 |
| 8. Krijimi i listës së çmimeve për AK-të për një plan të prokurimit të zbatueshëm dhe racional ..... | 27 |
| 9. Konkluzione dhe Rekomandime.....                                                                  | 29 |
| Aneks I. Kontratat e selektuara për monitorim në kategorinë furnizim, shërbim dhe punë.....          | 31 |

## I. Lista e shkurtesave

**AQP** - Agjencia Qendrore e Prokurimit  
**AK** - Autoritet Kontraktues  
**ASK** - Agjencia e Statistikave të Kosovës  
**INPO** - Iniciativa për Progres  
**KRPP** - Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik  
**LNB** - Ligji për Ndarjet Buxhetore  
**LMFP** - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit  
**LPP** - Ligji për Prokurim Publik  
**MAPL** - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
**MASHTI** - Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
**MBPZHR** - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
**ME** - Ministria e Ekonomisë  
**MFPT** - Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve  
**MINT** - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë  
**MKRS** - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
**NJK** - Njësi e kërkesës  
**RrP** - Rregullore për Prokurim Publik  
**ZKA** - Zyra Kombëtare e Auditimit  
**ZP** - Zyra e Prokurimit  
**ZPP** - Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit

## 2. Përmbledhje ekzekutive

Implementimi dhe zbatimi i i planeve të prokurimit fillon me hartimin e një strategjie të qartë dhe të detajuar për të identifikuar nevojat e furnizimeve, shërbimeve apo punëve përmes dokumentit të aprovuar nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, i cili është i njohur si Formulari B01 - Planifikimi i Prokurimit. Parimi 29 i OECD/SIGMA e përkufizon më së miri se si autoritetet kontraktuese duhet të hartojnë plane të prokurimit vjetore të harmonizuara me planifikimin buxhetor dhe të njëjtat duhet të publikohen në kohë dhe se analiza e plotë e nevojave dhe studimi i tregut orientojnë përgatitjen e prokurimit individual, duke përfshirë përcaktimin e rezultateve të dëshiruara. Në këtë rast, hulumtimi i tregut për të identifikuar furnizuesit apo kontraktuesit e shërbimeve dhe punëve është element kyç për zhvillimi i aktiviteteve të prokurimit, nënshkrimin, dhe implementimin e kontratës.

Tutje, zbatimi dhe implementimi i planit të prokurimit përfshin një sërë hapash që sigurojnë se qëllimet e planifikimit të prokurimit të arrihen me sukses dhe në përputhje me standardet e vendosura nga autoritetet kontraktuese. Një implementim i suksesshëm i planit të prokurimit kërkon një koordinim të mirë mes zyrës së prokurimit (tuje: ZP) dhe njësive të kërkesës (tuje: NJK). Kjo qasje përfshinë sigurimin e një transparencë të plotë dhe të dokumentuar në çdo fazë të procesit të prokurimit të cilat ndërlidhen me shpenzimin e parasë publike.

Qëllimi i këtij raporti është që të trajtohen aspektet ligjore dhe praktike të hartimit dhe implementimit të planifikimit të prokurimit, përputhshmërinë dhe përshtatshmërinë me planifikimet buxhetore, analizën e tregut dhe gjendjen aktuale të Ministrive dhe Zyrën e Kryeministrit në raport me planin vjetor të prokurimit.

INPO në kuadër të vlerësimit të planifikimit vjetor të prokurimit ka përzgjedhur dyzetë (40) kontrata për monitorim në shtatëmbëdhjetë (17) Autoritete Kontraktuese (tutje: AK), respektivisht gjashtëmbëdhjetë (16) Ministri dhe Zyrën e Kryeministrit të Kosovës. Megjithatë, nga shtatëmbëdhjetë (17) AK të monitoruara, njëmbëdhjetë (11) prej tyre nuk kanë arritur që të nënshkruajnë kontrata për furnizim dhe punë deri më 31.05.2024 për aq sa është edhe periudha e monitorimit, përkatësisht: *Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës, Zyra e Kryeministrit të Kosovës* nuk kanë arritur të nënshkruajnë asnjë kontratë në kategorinë e furnizimeve, ndërsa, *Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Turizmit, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Punëve të Brendshme* për investime kapitale. Nga njëzet e nëntë (29) kontrata të nënshkruara nga shtatëmbëdhjetë (17) AK në kategorinë e furnizimeve dhe shërbimeve, njëzetë (20) prej tyre janë të parapara në planin përfundimtar të prokurimit, gjersa nëntë (9) prej tyre janë nënshkruar pa qenë fare të planifikuara.

Gjetjet kryesore të këtij raporti konsistojnë të jenë:

I) Autoritetet Kontraktuese nuk i përmbahen detajeve formale të Formularit B01, në përgjithësi nuk përmbajnë detajet e nevojshme lidhur me aktivitetet për furnizim, shërbime dhe punë.

II) Autoritetet Kontraktuese iniciojnë dhe nënshkruajnë kontrata të cilat nuk parashihen fare në planin përfundimtar të prokurimit, madje për kontratat e nënshkruara pa

planifikimi nuk ka justifikime të cilat do të arsyetonin inicimin dhe nënshkrimin e një kontratë që nuk ka ndonjë buxhet të destinuar paraprak.

III) INPO gjatë hartimit të këtij raporti, ka gjetur se ende nuk ka ndonjë listë të çmimeve referente e aprovuar nga KRPP e cila do të bënte një plan të prokurimit të zbatueshëm dhe racional.

IV) INPO ka hasur në mungesë të koordinimit dhe bashkëpunimit të mirëfilltë në mes të Zyrës së Prokurimit dhe Njesisë së Kërkesës në kuadër të AK-ve, kjo sepse gjatë procesit të hartimit të planifikimit të prokurimit jo të gjitha palët kontribuojnë në këtë proces.

Përkitazi me gjetjet kryesore, INPO ka listuar disa rekomandime për AK-të:

I) INPO rekomandon KRPP-në që të fuqizoj mekanizmat monitorues ndaj planit të prokurimit për tu siguruar që i njëti zbatohet dhe implementohet në praktikë konform rregullave të përcaktuara ligjore.

II) Autoritetet Kontraktuese duhet të sigurohen se të gjitha nevojat e tyre për kontraktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve përfshihen në planin e prokurimi në të kundërtën nëse nuk përfshihen atëherë plani i prokurimit nuk respektohet dhe vështirë se i njëjti mund të implementohet dhe zbatohet në mënyrë racionale.

III) INPO kërkon nga KRPP krijimin e listave me çmime referente *obligative* në të cilën do të bazoheshin të gjitha AK-të gjatë fazës së përgaditjes së një prokurimit, qoftë: furnizim, shërbim apo punë.

IV) INPO konsideron se për të pasur një plan efikas dhe efektiv i njëjti duhet të përfshijë të gjitha palët gjatë fazës së hartimit të tij meqë kjo konsiderohet përgjegjësi e njesisë së kërkesës dhe zyrës së prokurimit sipas kornizës ligjore, andaj nevojitet një bashkëpunimin i mirëfillt në mes të këyre departamenteve.

### 3. Metodologjia

INPO me qëllim që të hartoj një raport përmbajtësor dhe në përputhje me objektivat e projektit ka përdorur metodologji të kombinuar të hulumtimit. Ky raport është hartuar duke analizuar planin e prokurimit për vitin 2024 të gjashtëmbëdhjetë (16) ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit<sup>1</sup>. Hulumtimi është i shtrirë në gjashtëmbëdhjetë (16) ministri, respektivisht në: Ministrinë e Administrimi të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Ekonomisë, Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë Industriale, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministrinë e Zhvillimit Rajonal dhe Zyrën e Kryeministrit të Kosovës.

Nga platforma e-prokurimi janë shkarkuar planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2024 për secilën autoritet kontraktues të monitoruar, ku është analizuar se këto plane a i përmbushin kriteret formale ligjore, respektivisht a janë hartuar planet e prokurimit konform kërkesave ligjore dhe procedurale të përcaktuara nga Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik përmes Formularit B01.

Hulumtimi është fokusuar në monitorimin e dyzetë (40) kontratave të nënshkruara përmes instrumentit të prokurimit për të vlerësuar nëse këto kontrata janë pjesë e planifikimit të prokurimit dhe a përputhen me të. Kontratat e përzgjedhura janë ato që kanë rezultuar me nënshkrim deri më 31.05.2024. Për shkak të buxhetit më të lartë të planifikuar për shpenzim në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, janë monitoruar kontratat në tri kategori (furnizim, shërbim dhe punë), ndërsa për ministrinë e tjera dhe Zyrën e Kryeministrit, janë përzgjedhur dy (2) kategori (furnizim, shërbim ose punë) bazuar në numrin më të lartë të kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2023 në ato kategori. Pra, për 11 ministri janë monitoruar nga dy (2) aktivitete, ndërsa në gjashtë (6) ministri janë monitoruar nga tri (3) aktivitete.<sup>2</sup>Pas kësaj është analizuar ajo se kontratat e selektuara për furnizim, shërbime dhe punë a kanë vlerë të përafërt të parashikuar si në plan ashtu edhe gjatë inicimit.

Gjithashtu, pjesë përbërëse e këtij raporti është edhe buxheti i ministrive i paraparë për vitin 2024, respektivisht buxheti për investime kapitale, nëse projektet kapitale të parapara në buxhetin e secilës ministri janë të inkoorporuara edhe në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2024, njëashtu edhe në Ligjin për Ndarje Buxhetore.

Gjithashtu, për grumbullimin e të dhënave është përdorur edhe metoda e intervistave gjysmë të strukturuar me zyrtarët përgjegjës të prokurimit. Përmes kësaj metode kemi përfshirë

---

<sup>1</sup> **Sqarim:** Gjashtëmbëdhjetë (16) Ministri sepse Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor funksionojnë si autoritete kontraktuese të ndara.

<sup>2</sup> Për më shumë shih Aneksin I në raportin e INPO-s, “Performanca e Qeverisë së Republikës së Kosovës në realizimin e planit të prokurimit”, 2024, i qasshëm në <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-Performanca-e-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-ne-realizimin-e-Prokurimit.pdf>

kombinimin e pyetjeve të strukturuar me ato të hapura, duke ju mundësuar të intervistuarve të shprehen lirshëm dhe në mënyrë të hollësishme për temat e caktuara, ndërsa INPO është përqendruar në marrjen e informacioneve specifike. Intervistat janë kryer individualisht me ZPP duke mundësuar një mbledhje të gjerë dhe të thelluar të të dhënave. Kjo qasje ka siguruar fleksibilitet dhe ka ofruar informacione më të gjëra rreth hartimit dhe implementimi të planifikimit të prokurimit. Intervistat janë realizuar me ZPP-të të Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

Të gjeturat e këtij raporti është konsultuar me zyrtarë përgjegjës të prokurimit në kuadër të ministrive gjatë zhvillimit të intervistave dhe komentet e dhëna janë pjesë e këtij raporti.

#### **4. Ndërthurja e problemeve të përhershme në planifikimin e prokurimit: Analizë dhe Alternativa**

Organizata INPO vazhdimisht përmes monitorimit të saj ka pasqyruar dhe analizuar problematikat të cilat ndërlidhën me planifikimin e prokurimit në nivelin lokal. Gjetjet sistematike përkojnë kryesisht me (i) *Mosrespektim të Formularit B01*, (ii) *Mospërputhje në mes të planifikimit dhe inicimit* dhe (iii) *Inicimi i aktiviteve të paplanifikuara*. Së fundmi, INPO ka shtrirë monitorimin në nivelin qendror përmes së cilit dëshmohej se edhe në nivelin qendror rezultojnë të jenë po të njëjtat problematika sa i përket planit vjetor të prokurimit dhe implementimin e tij në praktikë.

Andaj, duke qenë se plani i prokurimit ndikon direkt në përmbushjen e objektivave dhe arritjen e planeve strategjike të autoritetit kontraktues, është e rëndësishme të kryhet një analizë e hollësishme e nevojave dhe të përpilohet një plan i prokurimit që reflekton ato nevoja në mënyrë të saktë, në të kundërtën çdo devijim paraqet planifikim të dobët, mospërmbushje të objektivave si dhe dobësi në menaxhimin e parasë publike.

Sipas Ligjit për Prokurim Publik (tutje: LPP), pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës të gjitha AK-të janë të obliguara ta përfundojnë Planifikimin Përfundimtar të Prokurimit për dymbëdhjetë (12) muajt e ardhshëm fiskal, i cili duhet të hartohet në detaje të arsyeshme dhe të përmbajë të gjitha detajet e nevojshme lidhur me planifikimin e një aktiviteti të caktuar dhe i njëjti duhet të dorëzohet në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (tutje: AQP).<sup>3</sup> Duke marrë për bazë afatet kohore për dorzim të planit të prokurimit në AQP, INPO ka gjetur se një numër i konsiderueshëm i autoriteteve kontraktuese, respektivisht ministri kanë tejkaluar afatin ligjor për dorzim të planit të prokurimit në AQP. INPO ka gjetur se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjis dhe Inovacionit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Mbrojtës, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë AK-të të cilat kanë dorëzuar planin vjetor të prokurimit jashtë afateve të parapara ligjore në AQP.

Tutje, INPO vlerëson se problematik tjetër e planifikimit të prokurimit është edhe kërkesa për analizë të hollësishme të nevojave e cila vjen si rezultat i mungesës së analizës së tregut. Në kuadër të Direktivave të Bashkimit Europian parashihen edhe konsultimet paraprake të tregut përpara fillimit të procedurave të prokurimit. Kjo ndodh me qëllim që planifikimi dhe zhvillimin e procedurës së prokurimit të mos ketë efektin e minimimit të konkurrencës dhe të mos rezultojë në shkelje të parimeve të mosdiskriminimit dhe transparencës.<sup>4</sup> Andaj, INPO konsideron se është e rëndësishme që të kryhen analiza të hollësishme të tregut gjatë fazës së hartimit dhe përgatitjes së planit të prokurimit, me qëllim që vlera e parashikuar të përputhet edhe me çmimet reale të tregut. Se në Kosovë ka mungesë të analizës së tregut e dëshmon edhe Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2023, i cili thekson edhe nevojën e përmisimit në kërkimin e tregut.<sup>5</sup>

<sup>3</sup> **Sqarim:** Ligji për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024 është miratuar më 29.12.2023, ndërsa afati i fundit për dorëzimin e planeve përfundimtare të autoriteteve kontraktuese është 15.01.2024

<sup>4</sup> Për më shumë shih Direktivat e Bashkimit Europian të qasshme në <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2014/24/oj>

<sup>5</sup> Për më shumë shih Raportin e Progresit për Kosovë për vitin 2023, i qasshëm në [https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report\\_SQ.pdf](https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf)

Për më tepër, nga intervistat e realizuara me Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit (tutje: ZPP) sa i përket përfshirjes së tyre në hartimin e planifikimit të prokurimit rezulton se në të gjitha ministrinë, aktivitetet e prokurimit vijnë nga njësitë e kërkesës, të cilat janë përgjegjëse edhe për përcaktimin e vlerave të parashikuara të kontratave. Koordinimi ndërmjet Njësive të Kërkesës dhe Zyrave të Prokurimit është një tjetër aspekt i rëndësishëm që shfaqet në të gjitha ministrinë, megjithëse niveli i koordinimit varion ndjeshëm. *SHEMBULL*: Zyra e Prokurimit e Ministrisë së Shëndetësisë ka mbajtur puntori me Njësitë e Kërkesës rreth hartimit të planit të prokurimit, ndërsa në Ministrinë e Arsimit dhe atë të Punëve të Jashtme dhe Diasporës ka nivel të ulët të koordinimit.<sup>6</sup> Kjo situatë shpërfaqë mungesën e koordinimit ndërmjet Zyreve të Prokurimit dhe Njësive të Kërkesës, andaj këto dy departamente duhet të sigurohen të rrisin bashkëpunimin ndërmjetvetë gjatë procesit të hartimit të planifikimit të prokurimit dhe të njëjtin mos ta shohin si përgjegjësi të ndarë por të përbashkët.

Si rezultat i rekomandimit të vazhdueshme të INPO-s ndaj KRPP-së për monitorim të planit të prokurimit dhe zbatueshmërisë së tij në praktikë KRPP që nga gjysma e dytë e vitit 2023 ka filluar përdorimin e metodologjisë së re të monitorimit ku njëra nga pikat në metodologjinë e monitorimit është edhe planifikimi i prokurimit. Sipas Raportit Vjetor të Punës së KRPP-së për vitin 2023, neni 8 i Ligjit për Prokurim Publik bën pjesë në mesin e neneve me numrin më të madh të intervenimeve të evidentuar me tridhjetë e katër (34) i cili i dedikohet planifikimit të prokurimit.<sup>7</sup>

Tutje, të dhënat e fundit të publikuara nga INPO që i dedikohen përmbushjes së planit të prokurimit për vitin 2023 në ministri dëshmojnë se rreth 48,63% e kontratave të nënshkruara nga të gjitha AK-të janë për aktivitete të prokurimit të cilat nuk janë planifikuar fare apo nuk figurojnë në plane të prokurimit të AK-ve.<sup>8</sup> Këto të dhëna paraqesin nevojën imediate për rikthimin e vëmendjes së AK-ve nga planifikimi i prokurimit i bazuar në indikatorë matës dhe ligjor duke i respektuar në plotëni kërkesat e Formularit B01.

Sidoqoftë, marrë parasysh problemet endemike të cilat ndërlidhen me moszbatim të Formularit B01 dhe planifikimit të prokurimit në tërësi, përveç ndryshimit të tij nevojitet edhe plotësim/ndryshimi i rregullores për prokurim publik në të cilën INPO rekomandon që inicimi i aktiviteteve të prokurimit të paplanifikuara pa një justifikim të bazuar mirë të konsiderohet shkelje në kuadër të legjislacionit i cili rregullon dhe trajton fushën e prokurimit publik. Nëse do të ekzistonte një dispozitë e tillë ligjore, AK-të do të hartonin dhe implementonin planin e prokurimit konform rregullave ligjore, madje edhe për inicimin dhe nënshkrimin e kontratave të paplanifikuara do të siguroheshin se arsyet janë të justifikuara dhe të arsyetuara mirë.

---

<sup>6</sup> Nga intervistat e realizuara me Zyrtarët përgjegjës të prokurimit

<sup>7</sup> Për më shumë shih Raportin Vjetor të Komisionit Rregullativ për Prokurim Publik për vitin 2023, i qasshëm në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=349>

<sup>8</sup> Për më shumë shih raportin e INPO-s, “Performanca e Qeverisë së Republikës së Kosovës në realizimin e prokurimit”, i qasshëm në <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-Performanca-e-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-ne-realizimin-e-Prokurimit.pdf>

## 5. Pasqyrë e përgjithshme e buxhetit të planifikuar në nivel qendror

Ligji për Prokurim Publik dhe Rregullorja për Prokurim Publik (tutje: RrP) parashohin planifikimin e prokurimit si hapin e parë procedural dhe ligjor të prokurimit publik. Përkitazi me LPP dhe RrP, KRPP ka hartuar Formularin B01<sup>9</sup> përmes së cilit AK duhet të përmbushin këtë obligim ligjor duke paraqitur të gjitha detajet e hollësishme siç janë titulli, sasitë, njësitë, artikujt dhe vlerën e parashikuar për aktivitetet që AK do të inicioj përgjatë dymbëdhjetë (12) muajve.

Kësisoj, në këtë kapitull do të pasqyrohet qartë dhe në mënyrë të përgjithshme buxheti i planifikuar për shpenzim të gjashtëmbëdhjetë (16) Ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit sa i përket të gjitha kategorive për vitin 2024. Kjo pasqyrë e përgjithshme e buxhetit ofron mundësi për monitorimin dhe vlerësimin e performancës së buxhetit të planifikuar në planin vjetor në realizimin e synimeve dhe rezultateve të parashikuara përgjatë një (1) viti fiskal nga niveli qendror.

**Buxheti i përgjithshëm sipas planit të prokurimit në nivel qendror<sup>10</sup>**

| Ministritë                                                  | Furnizim      | Shërbim       | Punë           | Konkurs projektimi | Total          |
|-------------------------------------------------------------|---------------|---------------|----------------|--------------------|----------------|
| Ministria e Administrimi të Pushtetit Lokal                 | 80,712.00     | 13,759.99     | N/A            |                    | 94,471.99      |
| Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | 23,076,885.09 | 560,100.00    | 44,970,000.00  | 120,000.00         | 68,726,985.09  |
| Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural      | 515,200.00    | 777,846.00    | 1,688,000.00   |                    | 2,981,046.00   |
| Ministria e Drejtësisë                                      | 182,349.80    | 299,255.00    | 120,000.00     |                    | 601,604.80     |
| Ministria e Ekonomisë                                       | 307,598.58    | 2,520,700.00  | 1,865,000.00   |                    | 4,693,298.58   |
| Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                | 1,819,800.00  | 1,415,000.00  | 4,740,000.00   |                    | 7,974,800.00   |
| Ministria e Infrastrukturës                                 | 294,410.00    | 7,091,200.00  | 230,475,000.00 |                    | 237,860,610.00 |
| Ministria e Mbrojtjes                                       | 8,232,888.00  | 19,905,998.00 | 12,115,000.00  |                    | 40,253,886.00  |
| Ministria e Shëndetësisë                                    | 23,500,771.48 | 1,831,021.46  | 52,377,289.67  | 152,888.00         | 77,861,970.61  |
| Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Turizmit            | 1,801,392.00  | 503,978.00    | 8,540,000.00   |                    | 10,845,370.00  |
| Ministria për Komunitete dhe Kthim                          | 610,000.00    | 148,500.00    | 2,010,000.00   |                    | 2,768,500.00   |
| Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit                    | 2,912,730.00  | 4,184,430.00  | 75,291,181.00  |                    | 82,388,341     |
| Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor             | 248,592.60    | 3,585,000.33  | 20,790,122.00  |                    | 24,623,714.93  |
| Ministria e Punëve të Brendshme                             | 8,109,876.00  | 4,072,900.00  | 13,291,500.00  |                    | 25,474,276.00  |

<sup>9</sup> Shih formularin B01, i qasshëm në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>

<sup>10</sup> Buxheti i përgjithshëm sipas planit vjetor të prokurimit të llogaritur për secilën ministri dhe Zyrën e Kryeministrit në të gjitha kategorit në planin e prokurimit.

|                                             |                       |                      |                       |                   |               |
|---------------------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|-------------------|---------------|
| Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës | 11,852,690.00         | 519,400.00           | 1,190,000.00          |                   | 13,562,090.00 |
| Ministria e Zhvillimit Rajonal              | 29,640.00             | 176,100.00           | N/A                   | 2,500.00          | 208,240.00    |
| Zyra e Kryeministrit të Kosovës             | 210,928.50            | 321,647.73           | N/A                   |                   | 532,576.23    |
| <b>Gjithsej:</b>                            | <b>83,786,464.05</b>  | <b>47,926,836.51</b> | <b>469,463,092.67</b> | <b>275,388.00</b> |               |
| Total buxheti:                              | <b>601,451,781.23</b> |                      |                       |                   |               |

**Tabela I.** Buxheti i përgjithshëm sipas planit të prokurimit në nivel qendror.

Në tabelën I është pasqyruar buxheti i planifikuar nga gjashtështëmbëdhjetë (16) Ministri dhe Zyra e Kryeministritë për të shpenzuar për një (1) vit fiskal në kategorinë e furnizimeve, shërbimeve, punës dhe konkurse projektimi. Vlera totale e paraparë nga shtatëmbëdhjetë (17) AK-të përgjatë 2024 është **601,451,781.23 euro**, ndërkaq të dhënat e paraqitura në tabelë pasqyrojnë edhe katër (4) ministritë me buxhetin më të lartë për këto shpenzime që janë: **Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjis, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.**

Sipas analizës dhe gjetjeve të INPO-s, në vitin 2023 vlera totale e aktiviteteve të planifikuara bazuar në planin e prokurimit në kategorinë e furnizimeve, shërbimeve dhe punë në nivelin qendror ishte 442,267,200.94€, ndërkaq vlera e kontratave të nënshkruara është mbi 83 milion euro apo vetëm 18.98% e vlerës së planifikuar në total.<sup>11</sup> Mirëpo, përkundër nënshkrimit të kontratave publike mbi 83 milion euro, sipas Raportit Vjetor Financiar të publikuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve vlera totale e shpenzimeve për mallra dhe shërbime përgjatë vitit 2023 është 24,553,350.00€, ndërsa niveli qendror për kategorinë e investimeve kapitale ka shpenzuar 55,022,636.00€.<sup>12</sup> Krahësuar me përqindje të bive që niveli qendror ka shpenzuar vetëm 18% të buxhetit të planifikuar për kategorinë e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve.

Mungesa e realizimit dhe shpenzimit të paras publike të planifikuar për një (1) vit fiskal paraqet problem në menaxhimin e financave publike, të cilat ndikojnë direkt në mirëqenien e qytetarëve. Në këtë rast, planifikimet e bëra për të gjitha kategoritë nuk përputhen fare me rezultatin e arritur në fund të përmbylljes së vitit fiskal. Se ka mungesë në realizimin e buxhetit dhe përmbushjen e tij e dëshmojnë edhe raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit (tutje: ZKA). Të gjeturat e raporteve të ZKA-së për vitin 2023 në ministri, dëshmojnë se buxheti i ministrive është realizuar në përqindje shumë të ulët, madje pasqyrohen për secilën ministri se cilat janë shkaqet dhe arsyet për mosrealizim të buxhetit të tërësishëm. Ndër shkaktarët kryesor të evidentuar në raportet e auditimit janë: (i) vonesa në vendimarrje në Organin Shqyrtues të Prokurimit (tutje: OShP), (ii) vonesa

<sup>11</sup> Për më shumë shih raportin e INPO-s, “Performanca e Qeverisë së Republikës së Kosovës në realizimin e prokurimit”, i qashtëm në <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-Performanca-e-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-ne-realizimin-e-Prokurimit.pdf>

<sup>12</sup> Për më shumë shih Raportin Vjetor Financiar të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve për vitin 2023, i qashtëm në <https://mfpt.rks-gov.net/desk/content/media/2ce1ad00-3873-401d-9727-08dadbdd80ee.pdf>

në procedurat e prokurimit dhe nënshkrim të kontratave, (iii) vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndryshim dhe reduktim të shpenzimeve.<sup>13</sup>

## 6. Planifikimi i prokurimit në nivel qendror

Planifikimi vjetor i prokurimit si hapi i parë ligjor dhe procedural paraqet procesin themelor që duhet ndjekur për të siguruar që prokurimi apo kontraktimi i nevojave të një autoriteti kontraktues të kryhet në mënyrë efikase dhe transparente, madje një plan i tillë duhet të jetë në harmoni me të gjitha dokumentet strategjike të një AK-je të caktuar. Andaj, një ndër arsyt kryesore të hartimit të planit vjetor të prokurimit është që shpenzimi i parasë publike të realizohet konform rregullave ligjore dhe prokurimet të zhvillohen dhe udhëhiqen në përputhje me ligjin dhe standardet e përcaktuara ligjore.

INPO në fillim të vitit 2024 ka analizuar Planin e Prokurimit për vitin 2023 dhe Raportin Vjetor të Kontratave të Nënshkruara Publike për një vit fiskal, respektivisht për vitin 2023 të gjashtëmbëdhjetë (16) ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit dhe gjetjet e kësaj analize tregojnë se këto AK nuk i përmbahen planifikimit të prokurimit duke marrë parasysh se gjysma e kontratave janë lidhur jashtë planit të prokurimit, madje edhe vlera e parashikuar e kontratave në planet vjetore të prokurimit dhe vlera e parashikuar e kontratave të inicuar për tenderim rezultojnë të jetë shumë më e lartë.<sup>14</sup>

Për dallim nga viti 2023, INPO këtë herë fokus dhe rëndësi të veçant do ti kushtoj respektimit dhe implementimit të planit të prokurimit për vitin 2024, për nga aspekti ligjor dhe praktikë. Kësisoj, në vijim do të gjeni të gjitha të dhënat për secilën kategori: furnizim, shërbim dhe punë ku pasqyrohet respektimi i planit të prokurimit nga gjashtëmbëdhjetë (16) ministri dhe Zyra e Kryeministrit të Kosovës.

### 6.1. Respektimi i Formularit B01 - Planifikimi i prokurimit

Formulari B01 është formular standard i aprovuar nga KRPP në kuadër të legjislacionit sekondar për planifikim të prokurimit. Ky formular është aprovuar dhe miratuar për të gjitha autoritetet kontraktuese me qëllim të pasqyrimin të sakt për të gjitha shpenzimet të cilat parashihen të realizohen në kuadër të të gjitha kategorive: furnizim, shërbim dhe punë. Madje, planifikimi i të gjitha furnizimeve, shërbimeve dhe punëve të cilat do të kontraktohen brenda një (1) viti fiskal janë një proces i obligueshëm ligjor dhe procedural.

Duke qenë se planifikimi i prokurimit është hallka e parë e prokurimit, i njëjti duhet të realizohet konform objektivave dhe qëllimeve të parapara nga një AK, meqë plani i prokurimit është lidhur ngusht me planin strategjik të një AK-je. Andaj, AK-të duke respektuar në plotëni Formularin B01 janë të obliguara që të hartojnë planin vjetor të prokurimit sipas detajeve të cilat kërkohen në këtë formular, respektivisht për **kategorinë për furnizim** kërkohen këto informata: (i) *Titulli i*

<sup>13</sup> Për më shumë shih Raportet e Auditimit të Pasqyrave Financiare për Ministrin pwr vitin 2023 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, të qasshme në <https://zka-rks.org/Reports?reportSubTypeId=10>

<sup>14</sup> Për më shumë shih raportin e INPO-s, "Performanca e Qeverisë së Republikës së Kosovës në realizimin e prokurimit", i qasshëm në <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2024/05/Raporti-Performanca-e-Qeverise-se-Republikes-se-Kosoves-ne-realizimin-e-Prokurimit.pdf>

aktivitetit, artikulli, (ii) njësia matëse, (iii) sasia e përafërt vjetore, (iiii) çmimi për njësi, (iv) vlera e parashikuar e kontratës dhe (v) data e planifikuar e fillimit të procedurave të prokurimit, ndërsa për **kategorinë e shërbimeve dhe punëve** nevojiten vetëm: (i) Titulli i aktivitetit, (ii) vlera e parashikuar e kontratës dhe (iii) data e planifikuar e fillimit të prokurimit.

INPO ka analizuar planet e prokurimit të të gjitha Ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit se a i përmbajnë të gjitha të kërkesat dhe detajet formale të aktivitetetve të planifikuara. Të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë:

| Respektimi i Formularit B01 – Planifikimi i Prokurimit <sup>15</sup> |                                                             |          |    |            |         |    |            |      |    |            |
|----------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|----------|----|------------|---------|----|------------|------|----|------------|
| Nr.                                                                  | Ministria                                                   | Furnizim |    |            | Shërbim |    |            | Punë |    |            |
|                                                                      |                                                             | Po       | Jo | Pjesërisht | Po      | Jo | Pjesërisht | Po   | Jo | Pjesërisht |
| 1.                                                                   | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                | ✓        |    |            | ✓       |    |            | N/A  |    |            |
| 2                                                                    | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | ✓        |    |            | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 3.                                                                   | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural      | ✓        |    |            | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 4.                                                                   | Ministria e Drejtësisë                                      |          |    | ✓          | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 5.                                                                   | Ministria e Ekonomisë                                       | ✓        |    |            | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 6.                                                                   | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                |          |    | ✓          | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 7.                                                                   | Ministria e Infrastrukturës                                 |          |    | ✓          | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 8.                                                                   | Ministria e Mbrojtjes                                       |          |    | ✓          | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 9.                                                                   | Ministria e Shëndetësisë                                    | ✓        |    |            | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 10.                                                                  | Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë         | ✓        |    |            | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 11.                                                                  | Ministria për Komunitete dhe Kthim                          |          |    | ✓          | ✓       |    |            | ✓    |    |            |
| 12.                                                                  | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit                    |          |    | ✓          | ✓       |    |            | ✓    |    |            |

<sup>15</sup> **Burimi:** Planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2024.

|                 |                                              |          |          |          |           |          |          |           |          |          |
|-----------------|----------------------------------------------|----------|----------|----------|-----------|----------|----------|-----------|----------|----------|
| 13.             | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor | ✓        |          |          | ✓         |          |          | ✓         |          |          |
| 14.             | Ministria e Punëve të Brendshme              |          |          | ✓        | ✓         |          |          | ✓         |          |          |
| 15.             | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës  |          |          | ✓        | ✓         |          |          | ✓         |          |          |
| 16.             | Ministria e Zhvillimit Rajonal               | ✓        |          |          | ✓         |          |          | ✓         |          |          |
| 17.             | Zyra e Kryeministrit të Kosovës              | ✓        |          |          | ✓         |          |          | N/A       |          |          |
| <b>Gjithsej</b> |                                              | <b>9</b> | <b>0</b> | <b>8</b> | <b>17</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>15</b> | <b>0</b> | <b>0</b> |

**Tabela 2.** Respektimi i Formularit B01 - Planifikimi i prokurimit.

Të dhënat e pasqyruara në tabelën më lartë tregojnë se një numër i konsiderueshëm i ministrive në Formularin B01 kanë përfshirë të gjitha detajet e nevojshme në aspekt formal të cilat kërkohen në formular. Rezultatet e hulumtimit tregojnë se nga shtatëmbëdhjetë (17) AK të monitoruara nëntë (9) prej tyre për kategorinë e furnizimeve, shërbime dhe punë i përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara, ndërsa tetë (8) nga to detajet formale i kanë në mënyrë të pjesshme, respektivisht, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, Ministria e Zhvillimit Rajonal, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Zyra e Kryeministrit të Kosovës në planet e tyre të prokurimit kanë përfshirë të gjitha detajet formale të cilat kërkohen në planifikimin e prokurimit. Ndërsa, ministrinë e tjera këto të dhëna i kanë në përputhje me kërkesat e Formularit B01 vetëm sa u përket aktiviteteve për shërbime dhe punë, kurse sa u përket aktiviteteve të planifikuara për furnizim të dhënat i përmbajnë në mënyrë të pjesshme. Faktori kryesor se pse të dhënat janë të pjesshme, është fakti se këto aktivitete nuk përmbajnë artikujt, sasitë apo njësitë, apo edhe nëse përmbajnë ato janë vetëm “shabllone” të cilat shërbejnë vetëm sa për ta plotësuar planin e prokurimit.

Në këtë situatë, është e rëndësishme që AK-të të zbatojnë në mënyrë të rregullt dhe të plotë planifikimin e prokurimit, respektivisht Formularin B01. Kjo gjithashtu përfshin edhe respektimin e rregullave dhe procedurave të caktuara për planifikimin, miratimin dhe monitorimin e formularit për të siguruar që të gjitha aktivitetet dhe procedurat e zhvilluara janë transparente, efikase, efektive dhe të ligjshme, kjo me qëllim të shmangies së keqperdorimeve eventuale të cilat ndërliken me zhvillimin dhe udhëheqjen e procedurave të prokurimit apo edhe me menaxhim të kontratave.

## 6.2. Respektimi i planit të prokurimit në kontratat për furnizim

Dukuria e inicimit të aktiviteteve të prokurimit dhe nënshkrimit të kontratave që nuk janë në përputhje me planin e prokurimit apo edhe kur iniciimi i aktiviteteve të prokurimit bëhet pa qenë fare të planifikuara është dukuri e shprehur edhe në institucionet e nivelit qendror.

Gjatë monitorimi dhe analizimit të planeve të prokurimit, INPO ka identifikuar institucionet që kanë nënshkruar kontrata të cilat nuk janë paraparë fare në planin e prokurimit apo edhe kur nënshkrimi i kontratave të planifikuara dhe vlera e tyre e parashikuar nuk përputhet me atë të planifikuar dhe të inicuar. Në tabelën më poshtë janë pasqyruar gjetjet për secilën ministri dhe Zyrën e Kryeministrit për kontratën e parë të nënshkruar për kategorinë e furnizimeve në vitin 2024, respektivisht secila kontratë është analizuar fillimisht se a mund të identifikohet në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2024 dhe nëse po, atëherë detajet e paraqitura a janë të njëjta si në planifikim të prokurimit, ashtu edhe gjatë inicimit dhe nënshkrimit të kontratës.

| Përputhja e kontratës për furnizim me planin përfundimtar të prokurimit |                                                                           |                           |                                                                       |    |            |
|-------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|---------------------------|-----------------------------------------------------------------------|----|------------|
| Nr.                                                                     | Ministria                                                                 | Planifikimi <sup>16</sup> | Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit <sup>17</sup> |    |            |
|                                                                         |                                                                           | I                         | Po                                                                    | Jo | Pjesërisht |
| 1.                                                                      | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal                              | /                         | /                                                                     | /  | /          |
| 2.                                                                      | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit <sup>18</sup> | x                         | -                                                                     | -  | -          |
| 3.                                                                      | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural                    | x                         | -                                                                     | -  | -          |
| 4.                                                                      | Ministria e Drejtësisë                                                    | /                         | /                                                                     | /  | /          |
| 5.                                                                      | Ministria e Ekonomisë                                                     | /                         | /                                                                     | /  | /          |
| 6.                                                                      | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                              | ✓                         | 0                                                                     | 0  | I          |
| 7.                                                                      | Ministria e Infrastrukturës                                               | /                         | /                                                                     | /  | /          |
| 8.                                                                      | Ministria e Mbrojtjes                                                     | ✓                         | 0                                                                     | 0  | I          |
| 9.                                                                      | Ministria e Shëndetësisë                                                  | ✓                         | 0                                                                     | 0  | I          |

<sup>16</sup> **Sqarim:** Shenja (/) nënkupton se Ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit deri më 31 maj 2024 nuk kanë arritur të nënshkruajn asnjë kontratë për furnizim.

<sup>17</sup> **Sqarim:** Shenja (x) nënkupton se kontrata është nënshkruar pa qenë fare e planifikuar, ndërsa shenja (✓) do të thotë se kontrata ka qenë e planifikuar.

<sup>18</sup> **Sqarim:** Gjatë zhvillimit të intervistave me zyrtarin përgjegjës të prokurimit, i njëjti ka theksuar se: “kontrata e nënshkruar për shërbim nuk parashihet në planin përfundimtar të prokurimit, meqë është donacion”.

|     |                                              |                                                                                               |   |   |   |   |   |   |         |         |         |
|-----|----------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|---|---|---|---|---|---|---------|---------|---------|
| 10. | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit     | ✓                                                                                             | 0 | 0 | 1 |   |   |   |         |         |         |
| 11. | Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor | x                                                                                             | - | - | - |   |   |   |         |         |         |
| 12. | Ministria e Punëve të Brendshme              | x                                                                                             | - | - | - |   |   |   |         |         |         |
| 13. | Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës  | ✓                                                                                             | 0 | 0 | 1 |   |   |   |         |         |         |
| 14. | Ministria e Zhvillimit Rajonal               | ✓                                                                                             | 0 | 0 | 1 |   |   |   |         |         |         |
| 15. | Zyra e Kryeministrit të Kosovës              | /                                                                                             | / | / | / |   |   |   |         |         |         |
|     | Gjithsej                                     | <table><tr><td>/</td><td>x</td><td>✓</td></tr><tr><td>5</td><td>4</td><td>6</td></tr></table> | / | x | ✓ | 5 | 4 | 6 | 0 nga 6 | 0 nga 6 | 6 nga 6 |
| /   | x                                            | ✓                                                                                             |   |   |   |   |   |   |         |         |         |
| 5   | 4                                            | 6                                                                                             |   |   |   |   |   |   |         |         |         |

**Tabela 3.** Përputhja e kontratave për furnizim me planin përfundimtar të prokurimit.

Të gjeturat e hulumtimit të pasqyruara në tabelën më lartë tregojnë se nga katërbëdhjetë (14) Ministrinë e monitoruara dhe Zyra e Kryeministrit të Kosovës për kategorinë e furnizimeve vetëm dhjetë (10) prej tyre kanë nënshkruar kontrata të cilat kanë qenë të planifikuara në planin vjetor të prokurimit, megjithatë detajet e kërkuara në planin e prokurimit dhe gjatë inicimit të aktiviteteve përputhën në mënyrë të pjesshme. Gjashtë (6) nga gjashtë (6) kontratat e planifikuara për nënshkrim nga ministrinë përputhjen e kontratës me planin e prokurimit e kanë në mënyrë të pjesshme, ndërsa katër (4) kontrata të nënshkruara nuk parashihen fare në planin vjetor të prokurimit. INPO gjatë selektimit të kontratave për monitorim ka hasur në një dukuri shqetësuese e cila rezulton të pasqyroj mungesën e efikasitetit për të arritur nënshkrimin e kontratës nga ministrinë dhe zyra e Kryeministrit, saktësisht pesë (5) nga pesëmbëdhjetë (15) AK-të të monitoruara nuk kanë arritur që të nënshkruajnë asnjë kontratë për kategorinë e furnizimeve deri më 31.05.2024.

Sipas ZPP-ve, gjatë hartimit të planifikimit të prokurimit aktivitetet për furnizime vijnë të pplotësuara nga Njësit e Kërkesës, ato plotësohet në momentin e inicimit. Për Ministrinë e Infrastrukturës plotësimi i të dhënave të kërkuara tek aktivitetet për furnizime do të ngarkonte shumë dokumentin B01, ndërsa Ministrina e Shëndetësisë pjesën më të madhe të buxhetit e shpenzon për aktivitetet që kanë të bëjnë me furnizime, kjo rezulton në koordinimi ndërmjet ZP dhe NJK meqë artikujt që përfshihen në plan të prokurimit janë përafërsisht të njëjtë nga viti në vit në dokumentin B01 tek aktivitetet për furnizime, andaj kjo është arsyeja pse formulari B01 është i plotësuar me të gjitha detajet e kërkuara.

Nënshkrimi i kontratave të prokurimit të paplanifikuara si dhe me buxhet të mangët shkakton pasoja të paparashikueshme gjatë implementimit të një kontratë, kjo sepse një kontratë e nënshkruar pa një buxhet të dedikuar dhe specifikuar qartë në një anë mund të çojë në mbingarkesë financiare për autoritetin kontraktues dhe në anën tjetër autoriteti kontraktues rrezikon të bëhet subjekt i ndjekjes ligjore për shkak të shkeljes së dispozitave ligjore nga ana e operatorëve ekonomik për nënshkrimin e kontratave pa mbështetje financiare.

Se përmbushja e kontratave të insitucioneve qendrore rrezikohen të mos realizohen apo realizimi të mos jetë në përputhje me kërkesat e projektit e dëshmon edhe raporti i ZKA-së për pasqyrat financiare vjetore të MMPHI-së për vitin 2023, ku janë evidentuar mangësi si pasojë e mungesës së planifikimit të duhur.<sup>19</sup>

### 6.3. Respektimi i planit të prokurimit në kontratat për shërbime

Formularin B01 për kategorin e shërbimeve nuk kërkon edhe shumë detaje të specifikuara. Të dhënat e vetme të cilat kërkojnë të vendosen në këtë formular janë: (i) titulli i aktivitetit, (ii) vlera e parashikuar e kontratës dhe (iii) data e planifikuar e fillimit të procedurave të prokurimit. Megjithatë, autoritet kontraktuese përkundër planifikimit të aktiviteteve të prokurimit nuk arrijnë që të inicojnë procedurat e prokurimit dhe nënshkrimin e kontratës brenda vlerës së paraparë dhe të planifikuar dhe as aspektin tjetër procedural i cili ndërlidhet me datën e planifikuar të fillimit të procedurës së prokurimit.

INPO në kuadër të këtij hulumtimi, ka analizuar kontratën e parë të nënshkruar për shërbime gjatë vitit 2024, nëse të njëjtat janë të planifikuara dhe nëse janë të planifikuara a janë respektuar detajet tjera të parapara me plan të prokurimit. Në tabelën më poshtë janë paraqitur detajet lidhur me këto gjetje për secilën Ministri dhe Zyrën e Kryeministrit.

| Përputhja e kontratës për shërbime me planin përfundimtar të prokurimit |                                                            |                           |                                                         |    |
|-------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|---------------------------|---------------------------------------------------------|----|
| Nr.                                                                     | Ministria                                                  | Planifikimi <sup>20</sup> | Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit |    |
|                                                                         |                                                            | I                         | Po                                                      | Jo |
| 1.                                                                      | Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal               | ✓                         | ✓                                                       | -  |
| 2                                                                       | Ministria e Arsimit, Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit | x                         | -                                                       | -  |
| 3.                                                                      | Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural     | ✓                         | ✓                                                       | -  |
| 4.                                                                      | Ministria e Drejtësisë                                     | x                         | -                                                       | -  |
| 5                                                                       | Ministria e Ekonomisë                                      | X                         | -                                                       | -  |
| 6                                                                       | Ministria e Infrastrukturës                                | ✓                         | ✓                                                       | -  |
| 7                                                                       | Ministria e Mbrojtjes                                      | ✓                         | ✓                                                       | -  |

<sup>19</sup> Për më shumë, shih raportin e Zyrës Kombëtare të Audimit për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, i qasshëm në [https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024\\_b0f13c4b-108a-46e7-b77b-0922f40f904a.pdf](https://zka-rks.org/cms/ReportFiles/2024_b0f13c4b-108a-46e7-b77b-0922f40f904a.pdf)

<sup>20</sup> **Sqarim:** Shenja (x) nënkupton se kontrata është nënshkruar pa qenë fare e planifikuar, ndërsa shenja (✓) do të thotë se kontrata ka qenë e planifikuar dhe përputhet ose jo me detajet me planin përfundimtar të prokurimit.

|          |                                                     |                                                                            |   |   |   |    |                                           |          |                                           |          |
|----------|-----------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------|---|---|---|----|-------------------------------------------|----------|-------------------------------------------|----------|
| 8        | Ministria e Shëndetësisë                            | x                                                                          | - | - |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 9        | Ministria Industrisë,<br>Ndërmarrësisë dhe Turizmit | x                                                                          | - | - |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 10       | Ministria për Komunitete dhe<br>Kthim               | ✓                                                                          | - | ✓ |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 11       | Ministria e Kulturës, Rinisë<br>dhe Sportit         | ✓                                                                          | ✓ | - |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 12       | Ministria e Punëve të<br>Brendshme                  | ✓                                                                          | - | ✓ |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 13       | Ministria e Punëve të Jashtme<br>dhe Diasporës      | ✓                                                                          | ✓ | - |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 14       | Ministria e Zhvillimit Rajonal                      | ✓                                                                          | - | ✓ |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 15       | Zyra e Kryeministrit të<br>Kosovës                  | ✓                                                                          | - | ✓ |   |    |                                           |          |                                           |          |
|          | Gjithsej                                            | <table><tr><td>x</td><td>✓</td></tr><tr><td>5</td><td>10</td></tr></table> | x | ✓ | 5 | 10 | <table><tr><td>6 nga 10</td></tr></table> | 6 nga 10 | <table><tr><td>4 nga 10</td></tr></table> | 4 nga 10 |
| x        | ✓                                                   |                                                                            |   |   |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 5        | 10                                                  |                                                                            |   |   |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 6 nga 10 |                                                     |                                                                            |   |   |   |    |                                           |          |                                           |          |
| 4 nga 10 |                                                     |                                                                            |   |   |   |    |                                           |          |                                           |          |

**Tabela 4.** Përputhja e kontratave për shërbime me planin përfundimtar të prokurimit.

Nga tabela më lartë vërejmë se nga katërmëdhjetë (14) ministritë dhe Zyra e Kryeministrit të monitoruara me nga një (1) kontratë për shërbim, pesë (5) prej tyre nuk parashihen fare në planin e prokurimit, ndërsa dhjetë (10) prej tyre janë paraparë në planin e prokurimit prej të cilave gjashtë (6) nga dhjetë (10) kontrata përputhen me detajet e paraqitura në planin e prokurimit, ndërsa katër (4) kontrata nga to nuk përmbajnë të dhënat sikur në plan të prokurimit ashtu edhe gjatë nënshkrimit të saj.

Kontratat për shërbim sipas LPP-së konsiderohen ato kontrata të lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë ofruesve të shërbimeve dhe nuk përfshijnë as furnizim dhe as punë, respektivisht kontrata për shërbime konsiderohen: kontratat e mirëmbajtjes, sigurisë, konsulencave apo të tjera të cilat nuk përfshijnë furnizim dhe punë brenda mardhënieve kontraktuale. Andaj, ekziston nevojë imediate për kontraktimin e këtyre shërbimeve, mirëpo të njëjtat duhet të jenë të planifikuara dhe të buxhetuara saktë për të shmangur problematikat e ndryshme të cilat mund të hasin autoritetet kontraktuese gjatë impementimit të tyre.

#### **6.4. Respektimi i planit të prokurimit në kontratat për punë**

Formulari B01 ashtu sikurse tek kategoria e shërbimeve edhe për kategorinë e punës nuk kërkon shumë detaje procedurale dhe formale të cilat nevojiten të plotësohen. Megjithatë, duke pasur parasysh kategorinë për punë si kategori më të shfrytëzueshme, meqë pjesa më e madhe e buxhetit orientohet tek investimet kapitale, një planifikim i tillë do të duhej të realizohej në përputhje me nevojat dhe strategjitë e përcaktuara për performancë të kënaqshme të një AK-je,

madje kjo e determinon edhe shpenzimin e parasë publike në mënyrë transparente, efikase dhe eficiente.

Në këtë rast, INPO ka analizuar kontratën e parë të nënshkruar nga ministritë për investime kapitale, me fokus në identifikimin se a është kjo kontratë e planifikuar në plan të prokurimit dhe nëse po a përputhet me detajet e paraqitura në planin vjetor të prokurimit. Andaj, të gjitha të dhënat i gjeni të paraqitura në tabelen më poshtë:

| Përputhja e kontratës për punë me planin përfundimtar të prokurimit |                                                             |                                                                                               |                                                                       |    |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
|---------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|----|---|---|---|---|-------------------------------------------|----------|-------------------------------------------|----------|
|                                                                     | Ministria                                                   | Planifikimi <sup>21</sup>                                                                     | Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit <sup>22</sup> |    |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
|                                                                     |                                                             | I                                                                                             | Po                                                                    | Jo |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 1.                                                                  | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit | /                                                                                             | /                                                                     | /  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 2.                                                                  | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                | ✓                                                                                             | -                                                                     | x  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 3.                                                                  | Ministria e Infrastrukturës                                 | ✓                                                                                             | ✓                                                                     | -  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 4.                                                                  | Ministria e Mbrojtjes                                       | ✓                                                                                             | ✓                                                                     | -  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 5.                                                                  | Ministria e Shëndetësisë                                    | /                                                                                             | /                                                                     | /  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 6.                                                                  | Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Turizmit            | /                                                                                             | /                                                                     | /  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 7.                                                                  | Ministria për Komunitete dhe Kthim                          | /                                                                                             | /                                                                     | /  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 8.                                                                  | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit                    | /                                                                                             | /                                                                     | /  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 9.                                                                  | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor             | ✓                                                                                             | ✓                                                                     | -  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 10.                                                                 | Ministria e Punëve të Brendshme                             | /                                                                                             | /                                                                     | /  |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
|                                                                     | Gjithsej                                                    | <table><tr><td>/</td><td>x</td><td>✓</td></tr><tr><td>6</td><td>0</td><td>4</td></tr></table> | /                                                                     | x  | ✓ | 6 | 0 | 4 | <table><tr><td>3 nga 10</td></tr></table> | 3 nga 10 | <table><tr><td>1 nga 10</td></tr></table> | 1 nga 10 |
| /                                                                   | x                                                           | ✓                                                                                             |                                                                       |    |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 6                                                                   | 0                                                           | 4                                                                                             |                                                                       |    |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 3 nga 10                                                            |                                                             |                                                                                               |                                                                       |    |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |
| 1 nga 10                                                            |                                                             |                                                                                               |                                                                       |    |   |   |   |   |                                           |          |                                           |          |

**Tabela 5.** Përputhja e kontratave për punë me planin përfundimtar të prokurimit.

Të dhënat në tabelën e paraqitur dëshmojnë se nga dhjetë (10) AK-të e monitoruara në kategorinë për punë vetëm katër (4) prej tyre kanë arritur që të nënshkruajnë kontrata për

<sup>21</sup> **Sqarim:** Shenja (x) nënkupton se kontrata është nënshkruar pa qenë fare e planifikuar, ndërsa shenja (✓) do të thotë se kontrata ka qenë e planifikuar dhe përputhet ose jo me detajet me planin përfundimtar të prokurimit.

<sup>22</sup> **Sqarim:** Shenja (/) nënkupton se AK-të nuk kanë arritur të nënshkruajnë kontratë për punë deri më 31.05.2024.

investime kapitale deri më 31.05.2024.<sup>23</sup> Nga tre (3) kontrata të nënshkruara që të tria (3) janë të parapara në planin e prokurimit, përjashtimisht kontrata e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve e cila përkundër planifikimit, e njëjta nuk përputhet me detajet e paraqitura në plan dhe gjatë fazës së nënshkrimit të saj.

Megjithatë, shqetësuese mbetet “(pa)aftësia” e institucioneve qendrore për nënshkrimin e kontratave për investimeve kapitale kur pothuajse gjashtë (6) mujor i parë i vitit 2024 ka kaluar. Gjashtë (6) nga dhjetë (10) ministritë e monitoruara nuk kanë arritur që të nënshkruajnë kontrata përkundër inicimit dhe zhvillimit të disa procedurave, psh: MINT përkundër inicimit të katër (4) aktiviteteve asnjëres prej tyre nuk ka arritur ti jap epilogun e kontratës së nënshkruar, madje njëra nga to është anuluar, MASHTI që nga janari deri më 31.05.2024 ka inicuar gjashtë (6) aktivitete të prokurimit, mirëpo nuk ka arritur ta nënshkruaj asnjëren prej tyre, historik i njëjët ka përcjellur edhe MKRS-n, e cila ka inicuar shtatë (7) aktivitete të prokurimit, dy (2) janë anuluar, megjithatë asnjëra nuk ka përfunduar me kontratë të nënshkruar. Përqindje të ulët të shpenzimeve kapitale e dëshmon edhe raporti tre mujor financiar i MFPT, ku nga gjashtëmbëdhjetë (16) ministri, gjashtë (6) nga to kanë 0% të shpenzimeve kapitale në tre mujorin e parë të vitit 2024, mirëpo sipas këtij raporti 116% më shumë është vlera e shpenzimeve për investime kapitale krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023.<sup>24</sup> Ndërsa, për vitin 2023 edhe Raporti i Progresit për Kosovën paraqet ekzekutim tejet të ulët të shpenzimeve kapitale publike e të cilat mund të krahasohet me një buxhet pothuajse të balancuar me vitin 2022.<sup>25</sup>

Mungesa e projekteve të investimeve kapitale për të cilën është përgjegjëse NJK është një nga arsyet e mos inicimit të disa aktiviteteve të parapara në planin e prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës për vitin 2024, ndërsa MKRS si Autoritet Kontraktues i shumë institucioneve vartëse përballet me vonesa sa i përket kërkesave për inicim nga po këto institucione vartëse, sfida të cilat janë duke ndikuar në mosrealizimin e planit të prokurimit.<sup>26</sup>

Për të parandaluar sfidat të cilat ndërlidhen me planifikim të prokurimit dhe mungesën e investimeve kapitale, është e rëndësishme që AK-të të angazhohen në hartimin e planeve të prokurimit të qarta dhe të detajuara për punë t'i zbatojnë ato me përpikëri dhe në përputhje me rregullat, procedurat e përcaktuara dhe planin vjetor të punës duke inicuar procedurat e prokurimit dhe nënshkrimit e kontratave brenda datave të parapara në plan dhe vlerës së parashikuar. Kjo mënyrë siguron që procedurat e prokurimit për punë dhe nënshkrimi i kontratave të bëhet në mënyrë të ligjshme, transparente dhe me përputhje me qëllimet dhe nevojat e AK-së në tërësi, kështu duke përmbushur edhe objektivat e parapara për një autoritet kontraktues.

---

<sup>23</sup> **Sqarim:** Periudha deri më 31.05.2024 përfshinë vetëm kontratat e nënshkruara me procedurë të hapur dhe jo me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.

<sup>24</sup> Për më shumë shih Raportin tre mujor financiar i MFPT për vitin 2024, i qasshëm në: <https://mfpt.rks-gov.net/Thesari/Page/33>

<sup>25</sup> Për më shumë shih Raportin e Progresit për Kosovë për vitin 2023, i qasshëm në: [https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report\\_SQ.pdf](https://integrimievropian.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/12/Kosovo-2023-Report_SQ.pdf)

<sup>26</sup> Informacion i siguruar nga intervistat e realizuara me Zyrtarët Përgjegjës të Prokurimit.

## **7. Planifikimi buxhetor vs Planifikimi i prokurimit**

Planifikimi buxhetor dhe planifikimi i prokurimit janë dy procese të ndryshme megjithatë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën sa i përket menaxhimit financiar dhe operacional të një organizate buxhetore. Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (tutje: LMFP) obligon ministrin e MFPT-ve që të nxjerrë qarkoren buxhetore për të gjitha organizatat buxhetore, me të cilat sigurohen udhëzime për përgatitjen e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.<sup>27</sup> Kjo qarkore përcakton tavanin e shpenzimeve të cilat i dedikohen një organizate të caktuar buxhetore brenda periudhës dymbëdhjetë (12) mujore, andaj mbi bazën e saj hartohen edhe shpenzimet të cilat parashihen nga një AK e caktuar në buxhetin e tyre si organizatë buxhetore dhe në plan të prokurimit për një (1) vit fiskal.

INPO në këtë kapitull do të fokusohet në buxhetimin dhe planifikimin e investimeve kapitale në nivelin qendror, respektivisht në ministri dhe Zyrën e Kryeministrit. Planifikimi i investimeve kapitale vjen pas aprovomit të atyre projekteve të buxhetura dhe specifikuara qartë së bashku me vlerën e projekteve të secilës organizatë buxhetore, ndërsa rregullat e prokurimit publik specifikojnë qartë se planifikimi i prokurimit duhet hartohet konform buxhetit të Autoriteti Kontraktues për vitin fiskal.

Përmes kërkesave për qasje në dokumente publike, INPO ka kërkuar buxhetin e secilës Ministri dhe Zyrës së Kryeministrit si organizatë e posaçme buxhetore sipas LMFP-së për të krahasuar projektet për investime kapitale në planifikimin buxhetor dhe planifikimin e prokurimit, megjithatë jo të gjitha institucionet qendrore janë përgjigjur pozitivisht në kërkesën e parashtuar. Vetëm MAPL-në, MBPZHR dhe ME-së kanë ofruar qasje në Buxhetin e organizatës së tyre, ndërkaq ministrinë e tjera përfshi edhe Zyrën e Kryeministrit nuk na kanë ofruar qasje. Ndaj kufizimit të qasjes në këto buxhete INPO ka parashtuar ankesa në Agjencinë për Informim dhe Privatësi për të gjitha Ministrinë dhe Zyrën e Kryeministrit.

### **7.1. Krahasimi i buxhetit dhe planit të prokurimit për investime kapitale**

Në Kosovë në mënyrë sistematike shifrat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e buxhetit është e orientuar drejt projekteve kapitale. Kjo situatë përcakton se përqindja më e madhe e të ardhurave të shtetit përdoren për të financuar projekte dhe infrastrukturë të re, megjithatë për iniciimin dhe implementimin e një kontrate për investimeve kapitale është e jetike që institucionet të kenë buxhetin e caktuar, të planifikuar mirë dhe të harmonizuar me njëri-tjetër në mënyrë që të sigurohet efikasitet dhe qëndrueshmëri financiare.

INPO në kuadër të këtij raporti, përveç analizimit të planifikimit të prokurimit nga aspekti ligjor dhe praktik ka trajtuar edhe aspektin e buxhetit të investimeve kapitale në kuadër të ministrive dhe Zyrës së Kryeministrit, nëse i njëjti përputhet me planifikimet buxhetore të një autoriteti të caktuar. Në këtë rast, në tabelën më poshtë gjeni të dhënat krahasimore në mes të Ligjit për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024 dhe Planifikimit të Prokurimit për (4) ministri të cilat kanë nënshkruar kontrata për investime kapitale deri më 31.05.2024.

---

<sup>27</sup> Për më shumë shih nenin 20 të Ligjit për Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësitë, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2524>

| Planifikimi buxhetor vs Planifikimi i prokurimit për investime kapitale <sup>28</sup> |                                                 |                                                                                                                           |                      |                          |
|---------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|--------------------------|
| Nr.                                                                                   | Ministria                                       | Kontrata                                                                                                                  | Planifikimi buxhetor | Planifikimi i prokurimit |
| 1.                                                                                    | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve    | Renovimi i Zyres së Pensioneve në Mitrovicë                                                                               | 5,271,342.00         | 120,000.00               |
| 2.                                                                                    | Ministria e Infrastrukturës                     | Ndërtimi i rrugës nga Ura e Haxhisë – Izhancë në Shtërpçë                                                                 | 1,700,000.00         | 1.700.000,00             |
| 3.                                                                                    | Ministria e Mbrojtjes                           | Ndërtimi i Shtëpizës montuese për nevoja të FSK-së                                                                        | 50,000.00            | 50,000.00                |
| 4.                                                                                    | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | Angazhimi i një OE për rrënimin e Objekteve pa leje në zona të mbrojtura dhe nevoja të tjera për Inspektoratin e MMPHI-së | N/A                  | 150,000.00               |

**Tabela 6.** Planifikimi buxhetor vs Planifikimi i prokurimit për investime kapitale.

Në tabelën 6 janë paraqitur AK-të për të cilat INPO ka krahasuar përshtatshmërin dhe përputhshmërin e planifikimeve buxhetore. Sipas të dhënave të paraqitura dëshmohet se të gjitha kontratat e nënshkruara janë të parapara në planin e prokurimit, megjithatë në Ligjin për Ndarjet Buxhetore për vitin 2024, vështirë që mund të identifikohen kontratat e nënshkruara për shkaqe dhe arsye të ndryshme. p.sh. Kontrata e MMPH nuk mund të identifikohet në kategorin e investimeve kapitale meqë e njëjta financohet nga kategoria për mallra dhe shërbime,<sup>29</sup> apo edhe kontrata e MFPT e cila ka emërtim gjeneral në kuadër të ligjit e që është “*Renovimi i objekteve ekzistuese të DAPK-se*” dhe kontrata e MM “*Ndërtime dhe Renovime*”. Tutje, siç mund të vërehet pjesa dermuese e projekteve kapitale të AK-ve të monitoruara përfshihen në LNB, madje të njëjtat janë edhe kontrata shumë-vjeçare, kjo është njëra ndër arsyet pse në disa raste dallon vlera e planifikimit në buxhet dhe plan të prokurimit, përkundër që rregullat për prokurim publik përcaktojnë saktë se termi “*kontratë shumë-vjeçare*” duhet të përdohet kur ekzekutimi i punëve zgjatë më shumë se një (1) vit në plan të prokurimit.

Përveç krahasimit të kontratave të para të nënshkruara nga AK-të për vitin 2024 për investime kapitale me Ligjin për Ndarje Buxhetore, INPO ka krahasuar edhe investimet e tjera kapitale të cilat Ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit kanë paraparë në buxhetet e tyre. Për shkak të kufizimit në qasje në dokumente publike nga institucionet qendrore në buxhetin e tyre, INPO ka analizuar dhe krahasuar vetëm buxhetin e MAPL-së, MBPZHR-së dhe ME-së të cilat janë përgjigjur pozitivisht.

Gjatë analizimit dhe identifikimit të nevojve të MAPL-së për investime kapitale, INPO ka gjetur se MAPL në kuadër të buxhetit të saj nuk ka paraparë shpenzime për investime kapitale, ashtu sikurse edhe në planin përfundimtar të prokurimit ku nuk parashihet asnjë projekt kapital. Ndërsa, në LNB, MAPL ka paraparë katër (4) aktivite në kuadër të kategorisë për investime kapitale. Të dhënat e detajizuara i gjeni në tabelën më poshtë:

<sup>28</sup> **Sqarim:** Krahasimi i kontratave të nënshkruar është realizuar konform Ligjit për Ndarje Buxhetore të vitit 2024 dhe Planifikimit të prokurimit 2024 të ministrive individualisht.

<sup>29</sup> Përgjigje e pranuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

| <b>Investimet kapitale të parapara në Ligjin për Ndarje Buxhetore nga MAPL</b> |                                                                                               |                      |                          |
|--------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|--------------------------|
| Nr.                                                                            | Projekti                                                                                      | Planifikimi buxhetor | Planifikimi i prokurimit |
| 1.                                                                             | Bashkëfinancimi me donatore për skemën e granteve të bazuar në performance komunale           | 4,000,000            | N/A                      |
| 2.                                                                             | Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkepunim nder-komunal | 50,000               | N/A                      |
| 3.                                                                             | Mbështetja për projektet infrastrukturore për komunitete në Komunitat e Republikës së Kosovës | 800,000              | N/A                      |
| 4.                                                                             | Zhvillimi dhe mirëmbajtja e platformës shtetërore E-Komunitat                                 | 100,000              | N/A                      |

**Tabela 7.** Investimet kapitale të parapara në Ligjin për Ndarje Buxhetore nga MAPL.

Sipas të dhënave të pasqyruara në tabelën më lartë, MAPL në buxhetin e saj dhe as në planifikimin e prokurimit nuk ka paraparë investime kapitale, megjithatë të njëjtat janë të parashikuara në Ligjin për Ndarjet Buxhetore të vitit 2024.

Ndryshe nga MAPL, MBPZHR në buxhetin e saj ka një mori të projekteve në kategorinë e investimeve kapitale, andaj të dhënat për këtë ministri si dhe krahasimin e planifikimit buxhetor i gjeni në tabelën në vijim:

| <b>Investimet kapitale të parapara në buxhetin e MBPZHR</b> |                                                                  |                      |                          |
|-------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|----------------------|--------------------------|
| Nr.                                                         | Projekti                                                         | Planifikimi buxhetor | Planifikimi i prokurimit |
| 1.                                                          | Hartimi i planeve menaxhuese                                     | 250,000.00           | N/A                      |
| 2.                                                          | Pyllzimi i sipërfaqeve të zhveshura                              | 320,000.00           | N/A                      |
| 3.                                                          | Kadastrit Pyjor -Reegjistrimi i Fondit Pyjor të Kosovës          | 500,000.00           | N/A                      |
| 4.                                                          | Rehabilitimi i Rrjetit rrugorë në zonat vreshtare të Kosovës     | 347,500.00           | 338.000,00               |
| 5.                                                          | Pajisje me ebuliometër elektronik                                | 2,500.00             | 55.000,00                |
| 6.                                                          | Ngritja e Kapaciteteve Laboratorike në IBK                       | 195,000.00           | N/A                      |
| 7.                                                          | Krijimi i kapaciteteve hulumtuese dhe prodhuese të pronave- tok  | 40,000.00            | N/A                      |
| 8.                                                          | Programi Kombëtar i Inventarit të Tokave Bujqësore të Republikës | 460,000.00           | N/A                      |
| 9.                                                          | Blerja e veturave speciale për mostrim                           | 10,000.00            | N/A                      |
| 10.                                                         | Furnizimi me pajisje të TI                                       | 90,000.00            | 5.000,00                 |

|     |                                                                          |            |            |
|-----|--------------------------------------------------------------------------|------------|------------|
| 11. | Ndërtimi i zyrës regjionale për Inspektoratin e AUV së në Ferizaj        | 160,000.00 | N/A        |
| 12. | Ndërtimi i zyrës regjionale për inspektoratit e AUV-së në Gjakovë 3      | 160,000.00 | N/A        |
| 13. | Blerja e veturave për Inspektoratin e AUV-së                             | 54,000.00  | N/A        |
| 14. | Pajisje e Laboratorit veterinar dhe ushqimit si dhe laboratorit nacional | 250,000.00 | N/A        |
| 15. | Ndërtimi i Objektivit të MBPZHR                                          | 980,000.00 | 980.000,00 |

**Tabela 8.** Investimet kapitale të parapara në Ligjin për Ndarje Buxhetore nga MBPZHR.

Në tabelën e pasqyruar më lartë dëshmohej se MBPZHR në kuadër të listës së saj për investime kapitale, përveç projekteve kapitale ka paraparë edhe furnizime dhe shërbime siç është rasti i “Pajisje me ebuliomter elektronik” e që edhe në planin përfundimtar të prokurimit është planifikuar në kategorinë e shërbimeve, ndërsa “Furnizimi me pajisje te TI”, në kuadër të furnizimeve.<sup>30</sup> Tutje, INPO ka gjetur se MBPZHR në kuadër të planit përfundimtar të prokurimit ka paraparë edhe “Renovimi i Objektivit të MBPZHR-së (ish objekti - AAKSë)”, projekt i cili nuk parashihet në buxhetin e ministrisë përkatëse për projekte kapitale.<sup>31</sup>

Të dhënat në vazhdim do të pasqyrohen për ME e cila bën pjesë në mesin e ministrive të cilat kanë ofruar qasje në buxhetin e tyre, respektivisht në projektet apo investimet kapitale për vitin 2024.

#### Projektet kapitale të parapara në buxhetin e ME

| Nr. | Projekti                                                                                         | Planifikimi buxhetor | Planifikimi i prokurimit |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|--------------------------|
| 1.  | Krijimi i CERT-it sektorial për sektorin e energjisë                                             | 300,000.00           | 300.000,00               |
| 2.  | Pilotimi i konceptit të Smart City (Neutral Host) në Komunën e Gjiçanit                          | 200,000.00           | 200.000,00               |
| 3.  | 4 Ndërtimi i QED - Prizren                                                                       | 50,000.00            | 600.000,00               |
| 4.  | Ndërtimi i stacionit sizmik sekondar - Llapushnik                                                | 15,000.00            | 15.000,00                |
| 5.  | Krijimi i pikës së vetme të informacionit për infrastrukturën fizike të komunikimeve elektronike | 200,000.00           | 200.000,00               |
| 6.  | Krijimi i Qendrës për Ekselence Digjitale në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) - Prizren  | 250,000.00           | N/A                      |
| 7.  | Pilotimi 5G                                                                                      | 600,000.00           | 1.400.000,00             |

<sup>30</sup> **Sqarim:** Për disa projektet e paraqitura në këtë tabelë është e rëndësishme të potencohet që janë projekte në vazhdim të cilat kanë filluar të implementohen që nga viti 2023.

<sup>31</sup> **Sqarim:** INPO është në dijeni që investime kapitale nuk konsiderohen vetëm ato të llojit punë, megjithatë kjo ndarje është bërë duke krahasur buxhetin e ministrisë dhe planin e prokurimit.

|     |                                                                                                              |              |            |
|-----|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------|------------|
| 8.  | Rezistenca klimatike për KRU-të                                                                              | 91,667.00    | N/A        |
| 9.  | Zbatimi i masave të EE në ndërtesat publike                                                                  | 2,800,000.00 | 250.000,00 |
| 10. | Programi i zbatimit të masave të EE                                                                          | 800,000.00   | 800.000,00 |
| 11. | Impianti për ujëra të zeza në Komunën e Prishtinës                                                           | 2,000,000    | N/A        |
| 12. | Projekti izhvillimit të ujerave të zeza në Gjilan dhe ndërtimi i implantit për trajtimin e ujerave në Gjilan | 3,152,014    | N/A        |
| 13. | Projekti i trajtimit të ujerave të zeza - Mitrovicë                                                          | 5,000,000    | N/A        |
| 14. | Ekonomia Dixhitale në Kosovë                                                                                 | 2,500,000    | N/A        |

**Tabela 9.** Investimet kapitale të parpara nga ME.

Në tabelën 9 janë paraqitur projektet kapitale të parpara nga ME në kuadër të buxhetit të saj. Ashtu sikurse MBPZHR e cila në kuadër të listës së projekteve kapitale ka paraparë edhe furnizime dhe shërbime, ngjashëm ka vepruar edhe ME. Këto të gjetura kanë derivuar nga krahasimi i planifikimit buxhetor dhe planifikimi i prokurimit, ku INPO ka identifikuar projektet të cilat parashihen në buxhetin e ministrisë dhe në planin e prokurimit, andaj nga kjo rezulton se projektet të cilat janë paraparë si projekte kapitale nga ME të njëjtat në kuadër të planit vjetor të prokurimit përfshihen në kategorinë e shërbimeve siç janë: *“Krijimi i CERT-it sektorial për sektorin e energjisë”*, *“Pilotimi i konceptit të Smart City (Neutral Host) në Komunën e Gjilanit”* dhe *Pilotimi 5G*. Ndërsa, të gjitha projektet kapitale të cilat janë paraparë në buxhetin e ministrisë për vitin 2024 të njëjtat janë të përfshira edhe në planin përfundimtar të prokurimit me vlerë të njëjtë të parashikuar, përjashtimisht *“4 Ndërtimi i QED - Prizeren”* dhe *“Zbatimi i masave të EE në ndërtesat publike”* të cilat kanë vlera të ndryshme në planifikim buxhetor dhe plan të prokurimit.<sup>32</sup>

Respektimi i planifikimeve dhe buxhetore dhe planit të prokurimit është jetik për menaxhimin financiar brenda një organizate buxhetore, sigurimin e mirëqenies financiare, efikasitetin dhe transparencën gjithashtu. Andaj, mosrespektimi i këtyre planifikimeve mund të shkaktojë edhe pasojat të cilat e rrezikojnë funksionimin dhe besueshmërinë e institucionit. Në këto rrethana, të gjitha AK-të duhet siguruar se janë në gjendje të planifikojnë dhe menaxhojnë me efikasitet dhe qëndrueshmëri burimet e tyre financiare për të arritur objektivat e tyre strategjike dhe për të mbrojtur integritetin e tyre institucional.

## **8. Krijimi i listës së çmimeve për AK-të për një plan të prokurimit të zbatueshëm dhe racional**

KRPP në vitin 2014 në bashkëpunim me Planet/Sigma kishte hartuar lista me çmim referente për produkte të ndryshme dhe njëri nga qëllimet ishte që gjatë planifikimit të aktiviteteve të prokurimit, AK-të të bazohen në këto lista në mënyrë që të vendosin një vlerë të parashikuar të

<sup>32</sup> **Sqarim:** INPO është në dijeni që investime kapitale nuk konsiderohen vetëm ato të llojit punë, megjithatë kjo ndarje është bërë duke krahasur buxhetin e ministrisë dhe planin e prokurimit.

përafërt dhe reale me çmimet e tregut. Këto lista nuk kanë qenë obligative për AK-të, andaj kjo ka bërë që këto lista me çmime referente të mos zbatohen.

Njëra nga temat që INPO ka trajtuar gjatë intervistimit të ZPP-ve është metodologjia që përdorë AK në përcaktimin e vlerës së parashikuar të një aktiviteti të prokurimit. Me përjashtim të Ministrisë së Shëndetësisë, mungesa e çmimeve referente u theksua si një problem i përbashkët tek të gjitha AK-të. Njësitë e Kërkesës si përgjegjëse për përcaktimin e vlerës së parashikuar bazohen në të shumtën e rasteve në kontrata paraprake ose çmime aktuale të tregut. Ndërsa, në Ministrinë e Shëndetësisë ekziston një komision i përbërë nga NJK të cilët në sajë të një rregullorje të përcaktimit të çmimeve dhe krahasimit të çmimeve aktuale në tregjet e Bashkimit Evropian parashikojnë vlerat e kontratave. Ministria e Mbrotjtjes kërkon nga NJK që përcaktimin e vlerës së parashikuar ta bëjnë pas marrjes së çmimeve referente nga tre (3) burime kredibile të huaja.

Përcaktimi i çmimeve referente është një komponent thelbësor në procesin e prokurimit publik, pasi ofron një bazë të besueshme që AK-të shmangin shpenzimet e panevojshme por edhe u përgjigjen mundësive për realizimin e aktivitetit. Në mungesë të çmimeve referente, autoritetet përballen me vështirësi në përcaktimin e vlerave të sakta të kontratave dhe rrezikojnë të bëjnë zgjedhje të gabuara që mund të dëmtojnë buxhetin dhe cilësinë e shërbimeve publike.

Për nevoja të këtij hulumtimi, INPO ka inkoorporuar edhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës në këtë raport. Përmes kërkesës për qasje në dokumente publike nga ky institucion kemi kërkuar informacione nëse ekziston ndonjë listë e çmimeve për produktet dhe punët të cilat blihen përmes procedurave të prokurimit. Megjithatë, ASK është rezervuar në përgjigje duke specifikuar shumë shkurtë “se ekzistojnë raste të tilla, mirëpo shumë rallë”. Tutje, INPO konsideron hap pozitiv ndërmarrjen e veprimeve nga ana e ASK-së në bashkëpunim me KRPP për një marrëveshje të mirëkuptimit për përgatitjen e një liste të çmimeve mesatare në treg.<sup>33</sup>

INPO nënvizon rëndësinë jetike për jetësimin e listave me çmime referente, apo krijimi një baze të re me çmime në nivel të Republikës së Kosovës, kjo meqë nga të dhënat e hulumtimit të INPO-së rezulton si një masë e domosdoshme. Ekzistimi i këtyre listave jo vetëm që do ta zvogëlonte punën e AK-ve në kuadër të planifikimit të prokurimit, mirëpo do të mundësonte që AK-të kur të planifikojnë aktivitete të prokurimit të vendosin një vlerë shumë të përafërt të kontratës, e jo ashtu siç ndodh sot praktikisht ku AK-të në shumë raste vlerën e parashikuar e vendosin shumë më të lartë se vlera reale e tregut, apo edhe e kundërta. Gjithashtu, ekzistimi i këtyre listave me çmime referente do ta ulte mundësinë që OE-të të ofronin çmime abnormalisht të ulëta, përkatësisht evidentimi i kësaj shkelje do të bëhej shumë më i lehtë dhe shumë më i shpejtë. Krijimi i listave të çmimeve për autoritete kontraktuese do të ndikonte në implementimin e një plani të prokurimit në mënyrë racionale.

---

<sup>33</sup> Përgjigje e siguruar përmes kërkesës për qasje në dokumente publike nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, dt.08.07.2024.

## 9. Konkluzione dhe Rekomandime

Institucionet qendrore nuk respektojnë afatet ligjore për dorëzimin e planit të prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit. Gjejet e këtij hulumtimi tregojnë se Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjis dhe Inovacionit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Mbrojtës, Ministria për Komunitete dhe Kthim, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë institucione të cilat kanë dorzuar jashtë afateve ligjore planin e prokurimit në AQP. Në këtë rast INPO rekomandon mbikëqyrje nga AQP sa i përket dorëzimit të planeve të prokurimit në AQP meqë kjo ndikon në identifikimin e nevojave në kuadër të prokurimeve të centralizura dhe vonesa në iniciimin e aktiviteteve dhe nënshkrim të kontratave.

INPO vlerëson se kërkesat e Formulari B01 - Planifikimi i prokurimit nuk përfillen. Nga shtatëmbëdhjetë (17) AK të monitoruara, nëntë (9) prej tyre për kategorinë e furnizimeve, shërbime dhe punë i përmbajnë të gjitha të dhënat e kërkuara në formular, ndërsa tetë (8) nga shtatëmbëdhjetë (17) AK detajet formale i kanë në mënyrë të pjesshme, përjashtimisht kategorisë për shërbim dhe punë ku të gjitha AK-të ju përmbahen detajeve, meqë nuk kërkohen shumë të dhëna. Andaj, INPO rekomandon KRPP-në që të fuqizoj mekanizmat monitorues ndaj planit të prokurimit për tu siguruar që i njëti zbatohet dhe implementohet në praktikë konform rregullave të përcaktuara ligjore.

AK nuk paraqesin detajet formale në planin perfundimtar të prokurimit siç janë: sasitë, njësitë dhe artikujt ashtu siç përcaktohet në kaudër të legjislacionit sekondar të prokurimit. INPO ka gjetur se nga katërmëdhjetë (14) Ministrinë të monitoruara dhe Zyra e Kryeministrit të Kosovës për kategorinë e furnizimeve vetëm dhjetë (10) prej tyre kanë nënshkruar kontrata të cilat kanë qenë të planifikuara në planin vjetor të prokurimit, megjithatë detajet e kërkuara në planin e prokurimit dhe gjatë iniciimit të aktiviteteve përputhën në mënyrë të pjesshme. Gjashtë (6) nga gjashtë (6) kontratat e planifikuara për nënshkrim nga ministrinë përputhjen e kontratës me planin e prokurimit e kanë në mënyrë të pjesshme, ndërsa katër (4) kontrata të nënshkruara nuk parashihen fare në planin vjetor të prokurimit.

Nga katërmëdhjetë (14) ministrinë dhe Zyra e Kryeministrit të monitoruara me nga një (1) kontratë për shërbim, pesë (5) prej tyre nuk parashihen fare në planin e prokurimit, ndërsa dhjetë (10) prej tyre janë paraparë në planin e prokurimit prej të cilave gjashtë (6) nga dhjetë (10) kontrata përputhen me detajet e paraqitura në planin e prokurimit, ndërsa katër (4) kontrata nga to nuk përmbajnë të dhënat sikur në plan të prokurimit ashtu edhe gjatë nënshkrimit të saj. Ndërsa, nga dhjetë (10) AK-të të monitoruara në kategorinë për punë vetëm katër (4) prej tyre kanë arritur që të nënshkruajnë kontrata për punë. Tre (3) nga të cilat janë të parapara në planin e prokurimit dhe dhe një kontratë e cila përkundër planifikimit, e njëjta nuk përputhet me detajet e paraqitura në plan dhe gjatë fazës së nënshkrimit të saj. Autoritetet Kontraktuese duhet të sigurohen se planifikojnë mirë këto kontrata në plane të prokurimit dhe i njëjti të jetë në përputhje me kapacitetin dhe nevojat buxhetore të AK-së në të kundërtën nëse plani i prokurimit nuk respektohet atëherë vështirë se i njëjti mund të implementohet dhe zbatohet në mënyrë racionale.

Nga intervistat e zhvilluara me zyrtarët përgjegjes të prokurimit , INPO ka hasur në mungesë të koordinimit dhe bashkëpunimit të mirëfilltë në mes të Zyrës së Prokurimit dhe Njesisë së Kërkesës, kjo sepse gjatë procesit të hartimit të planifikimit të prokurimit jo të gjitha palët kontribuojnë në këtë proces. INPO konsideron se për të pasur një plan efikas dhe efektiv i njëjti duhet të përfshijë të gjitha palët gjatë fazës së hartimit të tij meqë kjo konsiderohet përgjegjësi e njesisë së kërkesës dhe zyrës së prokurimit sipas kornizës ligjore.

INPO gjatë monitorimit dhe hartimit të këtij raporti ka gjetur se mungesa e analizës së tregut është dukuri e cila shpërfaqet edhe në nivelin qendror, kjo sepse Autoritetet Kontraktuese gjatë fazës së hartimit të planit të prokurimit nuk definojnë nevojat e AK-së saktë duke u bazuar në strukturën e tregut si dhe trendet e çmimeve dhe aspektet e tjera të cilat ndërlidhen me tregun. INPO nënvizon rëndësinë jetike të përdorimit të lisës së Çmimeve Referente dhe aprovimin e tyre nga KRPP dhe gjithashtu rekomandon bashkëpunim të AK-ve me Agjencinë e Statistikave të Kosovës sa i përket listës së çmimeve të produkteve apo punëve të cilat blihen përmes instrumentit të prokurimit.

INPO vlerëson se AK-të duhet të sigurohen se respektojnë Ligjin për Qasje në Dokumente Publike, meqë trembëdhjetë (13) ministri dhe Zyra e Kryeministrit kanë heshtur në raport me kërkesat për qasje në dokumente publike të adresuara në këto institucione të cilat objekt kërkesë kanë pasur buxhetin e secilës ministri për vitin 2024.

## Aneks I. Kontratat e selektuara për monitorim në kategorinë furnizim, shërbim dhe punë

| MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE  |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
|-----------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------|-----------|----------------|-----------------|-----------|
| Kontrata e parë për furnizim gjatë vitit 2024 |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Nr                                            | Titulli i kontratës                                                                                                                                                                                         | Planifikimi        |        |           | Inicimi        |                 |           |
|                                               |                                                                                                                                                                                                             | Sasia              | Njësia | Vlera €   | Sasia          | Njësia          | Vlera €   |
| I.                                            | Vazhdimi i garancisë dhe mbështetjes për pajisje të TI-së ( DELL-EMC Storage Unity 400, Cisco ASA 5516x Fireëall)<br>Numri i prokurimit: 201.-24-1262-1-2-1                                                 | N/A <sup>34</sup>  | N/A    | 50,000.00 | 41             | Muaj            | 29,000.00 |
| Kontrata e parë për punë gjatë vitit 2024     |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Nr                                            | Titulli i aktivitetit                                                                                                                                                                                       | Planifikim/Vlera € |        |           | Inicim/Vlera € |                 |           |
| I.                                            | Renovimi i Zyres së Pensioneve në Mitrovicë<br>Numri i prokurimit: 201.-24-2046-5-2-1                                                                                                                       | 120,000.00         |        |           | 113,000.00     |                 |           |
| MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME                 |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Kontrata e parë për furnizim gjatë vitit 2024 |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Nr                                            | Titulli i kontratës                                                                                                                                                                                         | Planifikimi        |        |           | Inicimi        |                 |           |
|                                               |                                                                                                                                                                                                             | Sasia              | Njësia | Vlera €   | Sasia          | Njësia          | Vlera €   |
| I.                                            | Furnizim me tiketa për dyer<br>Numri i prokurimit: 216-24-1808-1-3-6                                                                                                                                        | N/A                | N/A    | 2,000.00  | 150            | cope            | 2,000.00  |
| Kontrata e parë për shërbime gjatë vitit 2024 |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Nr                                            | Titulli i kontratës                                                                                                                                                                                         | Planifikim/Vlera € |        |           | Inicim/Vlera € |                 |           |
| I.                                            | Shërbimet e mbikëqyrjes për aktivitetin riorganizimi i hyrjes në MPJD, ndarja e hyrjes protokolare, hyrja e stafit, rregullimi i terasave dhe fasadimi i objektit”<br>Numri i prokurimit: 216-24-2574-2-2-1 | 25,000.00          |        |           | 25,000.00      |                 |           |
| MINISTRIA E DREJTËSISË                        |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Kontrata e parë për furnizim gjatë vitit 2024 |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Nr                                            | Titulli i kontratës                                                                                                                                                                                         | Planifikimi        |        |           | Inicimi        |                 |           |
|                                               |                                                                                                                                                                                                             | Sasia              | Njësia | Vlera €   | Sasia          | Njësia          | Vlera €   |
| I.                                            | N/A                                                                                                                                                                                                         | N/A                | N/A    | N/A       | N/A            | N/A             | N/A       |
| Kontrata e parë për shërbime gjatë vitit 2024 |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Nr                                            | Titulli i kontratës                                                                                                                                                                                         | Planifikim/Vlera € |        |           | Inicim/Vlera € |                 |           |
| I.                                            | “Shërbimet e pastrimit dhe mirëmbajtjes së hapsirave të objektit të ANJF-as”.<br>Numri i prokurimit: 21500-24-1097-2-2-1                                                                                    | N/A                |        |           | 13,680.00      |                 |           |
| MINISTRIA E MBROJTËS                          |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Kontrata e parë për furnizim gjatë vitit 2024 |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Nr                                            | Titulli i kontratës                                                                                                                                                                                         | Planifikimi        |        |           | Inicimi        |                 |           |
|                                               |                                                                                                                                                                                                             | Sasia              | Njësia | Vlera €   | Sasia          | Njësia          | Vlera €   |
| I.                                            | Furnizim me pjesë ndërrimi dhe shërbimet e mirëmbajtjes për automjetin Audi A7 për nevojat e MM-së<br>Numri i prokurimit: 217-24-1960-1-2-1                                                                 | N/A                | N/A    | 30.000,00 | 99<br>30       | Copë<br>Komplet | 30,000.00 |
| Kontrata e parë për shërbime gjatë vitit 2024 |                                                                                                                                                                                                             |                    |        |           |                |                 |           |
| Nr                                            | Titulli i kontratës                                                                                                                                                                                         | Planifikim/Vlera € |        |           | Inicim/Vlera € |                 |           |
| I.                                            | Shërbimet e Transportit të pajisjeve jashtë vendit për nevojat e FSK-së.<br>Numri i brokurimit: 217-24-1006-2-1-1                                                                                           | 135,000,00         |        |           | 135,000.00     |                 |           |

<sup>34</sup> Shenja (N/A) nënkupton se kontrata e nënshkruar nuk ka qenë e planifikuar, ndërsa kur është N/A gjatë inicimit dhe nënshkrimit nënkupton që një AK nuk ka nënshkruar kontratë fare deri më 31.05.2024 për një kategori të caktuar.

| Kontrata e parë për punë gjatë vitit 2024                   |                                                                                                                           |                    |        |              |                                |                                                                 |              |
|-------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------|--------|--------------|--------------------------------|-----------------------------------------------------------------|--------------|
| Nr                                                          | Titulli i kontratës                                                                                                       | Planifikim/Vlera € |        |              | Inicim/Vlera €                 |                                                                 |              |
| I.                                                          | Ndërtimi i Shtëpizës montuese për nevoja te FSK-së<br>Numri i prokurimit: 217-24-1485-5-2-1                               | 50,000.00          |        |              | 50,000.00                      |                                                                 |              |
| MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME                             |                                                                                                                           |                    |        |              |                                |                                                                 |              |
| Kontrata e parë për furnizim gjatë vitit 2024               |                                                                                                                           |                    |        |              |                                |                                                                 |              |
| Nr.                                                         | Titulli i kontratës                                                                                                       | Planifikimi        |        |              | Inicimi                        |                                                                 |              |
|                                                             |                                                                                                                           | Sasia              | Njësia | Vlera €      | Sasia                          | Njësia                                                          | Vlera €      |
| I.                                                          | Furnizim me ribona për printim te kartelave për armë dhe punetorët fizik për DSP<br>Numri i prokurimit: 214-24-2096-1-3-6 | N/A                | N/A    | N/A          | 40                             | copë                                                            | 9,800.00     |
| Kontrata e parë për shërbime gjatë vitit 2024               |                                                                                                                           |                    |        |              |                                |                                                                 |              |
| Nr                                                          | Titulli i kontratës                                                                                                       | Planifikim/Vlera € |        |              | Inicim/Vlera €                 |                                                                 |              |
| I.                                                          | Mirëmbajtja e Sistemit Elektronik te Gjendjes Civile<br>Numri i prokurimit: 214-23-14351-2-1-1                            | 60,000.00          |        |              | 350,000.00                     |                                                                 |              |
| Kontrata e parë për punë gjatë vitit 2024                   |                                                                                                                           |                    |        |              |                                |                                                                 |              |
| Nr                                                          | Titulli i kontratës                                                                                                       | Planifikim/Vlera € |        |              | Inicim/Vlera €                 |                                                                 |              |
| I.                                                          | N/A                                                                                                                       | N/A                |        |              | N/A                            |                                                                 |              |
| MINISTRIA E SHËDETËSISË                                     |                                                                                                                           |                    |        |              |                                |                                                                 |              |
| Kontrata e parë për furnizim gjatë vitit 2024               |                                                                                                                           |                    |        |              |                                |                                                                 |              |
| Nr.                                                         | Titulli i kontratës                                                                                                       | Planifikimi        |        |              | Inicimi                        |                                                                 |              |
|                                                             |                                                                                                                           | Sasia              | Njësia | Vlera €      | Sasia                          | Njësia                                                          | Vlera €      |
| I.                                                          | Ritender “Furnizim me produkte specifike për sëmundje te rralla nga LE”<br>Numri i prokurimit: 206-24-127-1-1-1           | 9182               | N/A    | 4,877,536.88 | 1248                           | copë                                                            | 1,307,421.93 |
| Kontrata e parë për shërbime gjatë vitit 2024               |                                                                                                                           |                    |        |              |                                |                                                                 |              |
| Nr.                                                         | Titulli i kontratës                                                                                                       | Planifikim/Vlera € |        |              | Inicim/Vlera €                 |                                                                 |              |
